

VENDIM
Nr. 718, datë 28.8.2013

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR LEJIMIN E PUNËSIMIT, PAS LIRIMIT
NGA DETYRA, TË NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit paraparak për lejimin e z. Sokol Ramadani, kryetar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), që, pas lirimit nga detyra, të punësohet në funksione tekniko-menaxhuese pranë kompanisë “Energji Ashta” sh.a., Tiranë, Shqipëri.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha